



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

**UDHËZUES PËR PARASHTRIMIN E KËRKESAVE
INDIVIDUALE
(KI)¹**

për

ndihmë palës, apo palëve, në parashtrimin e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në bazë të paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], në ndërlidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të neneve 46 (Lejueshmëria), 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës), 49 (Afatet) dhe 50 (Kthimi në gjendje të mëparshme) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

¹ Ky Udhëzues nuk paragjykon në asnjë mënyrë çështjen e pranueshmërisë apo meritave të kërkesës të përcaktuar në Kushtetutë, Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese, dhe/ose rezultatin e vendimmarrjes së Gjykatës.

Vërejtje paraprake

1. Këto udhëzime janë hartuar për t'ju ndihmuar për parashtrim të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Megjithatë, para se të vendosni të parashtroni kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duhet të jeni të njohur veçanërisht me paragrafin 7 të nenit 113, në ndërlidhje me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës; me nenin 22 dhe me nenet nga 46 e deri në 50 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, si dhe me rregullat nga 27 (Adresa për dorëzimin e dokumenteve) e deri në 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës Nr. 01/2023 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të cilat përcaktojnë kriteret ligjore që duhet të përmbushen për t'ia mundësuar Gjykatës Kushtetuese të shqyrtojë kërkesën tuaj.
2. Nëse mendoni se keni përmbushur të gjitha kriteret ligjore, të përcaktuara me këto dispozita, atëherë plotësojeni Formularin e kërkesës të publikuar në ueb-faqen e Gjykatës apo ekuivalentin e saj, sipas udhëzimeve të ofruara më poshtë.

Çështjet që mund të parashtrohen në Gjykatën Kushtetuese

3. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës dhe të pajtueshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.
4. Gjykata Kushtetuese mund të shqyrtojë kërkesat e parashtruara nga individët ose nga personat juridikë, që pohojnë se nga autoritetet publike u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ju duhet të lexoni Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës, i cili përmban këto të drejta dhe liri themelore të njeriut.
5. Nëse konsideroni se ju, personalisht dhe drejtpërsëdrejti, jeni viktimë e shkeljes së një apo më shumë të drejtave themelore të përcaktuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës, mund ta parashtroni çështjen në Gjykatën Kushtetuese.
6. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese mund të trajtojë vetëm kërkesat që kanë të bëjnë me shkeljen e një ose të më shumë të drejtave të parapara me Kushtetutë apo Konventat dhe/ose instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës, sipas nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës. Gjykata nuk mund të veprojë si gjykatë apeli (si shkallë e katërt) për vendimet që janë marrë nga gjykatat, roli i të cilave është të interpretojnë dhe të aplikojnë rregullat e të drejtës procedurale dhe materiale.
7. Gjykata mund të shqyrtojë vetëm kërkesat që drejtohen kundër autoriteteve publike të Republikës së Kosovës (organeve shtetërore, autoriteteve administrative, gjykatave, etj.), për të cilat pretendohet të kenë shkelur të drejtat dhe liritë tuaja themelore të garantuara me Kushtetutë.
8. Në bazë të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata mund të pranojë kërkesa vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive, të përcaktuara me ligjet në fuqi. Kjo do të thotë që, para se të parashtroni kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duhet të keni provuar më herët të merrni vendimin nga gjykatat për çështjet që ngrini në kërkesë, duke përfshirë edhe vendimin më të fundit nga gjykata më e lartë kompetente. Nëse nuk e keni shfrytëzuar atë mjet juridik, ju duhet të vërtetoni që ai mjet do të ishte i paefektshëm apo që ai mjet juridik nuk ekziston. Për më tepër, duhet të vërtetoni që jeni ankuar tek autoritetet publike dhe te gjykatat për të njëjtat shkelje të të drejtave kushtetuese (të paktën në substancë) që po i parashtroni në Gjykatën Kushtetuese.

9. Kur iniciatori procedurë në gjykatë, duhet t'u përmbaheni rregullave procedurale në fuqi, duke përfshirë edhe rregullin e respektimit të afateve kohore. Nëse, për shembull, gjykata ka hedhur poshtë kërkesën apo ankesën tuaj, për shkak se e keni dorëzuar tepër vonë, apo se atë e keni dorëzuar në gjykatën e gabuar, apo nuk keni përdorur procedurën e duhur, Gjykata Kushtetuese nuk do të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën tuaj.
10. Për më tepër, nëse ankoheni që një gjykatë, në procedurë administrative, penale, apo civile, ka shkelur të drejtën tuaj për gjykim të drejtë, nuk duhet të kërkonti rishikimin/rigjykimin e rastit pasi të keni shteruar procedurat normale të shterimit të mjeteve në gjykata të rregullta. Gjithashtu, për t'iu drejtuar Gjykatës lidhur me këto procedura, nuk keni nevojë as të shfrytëzoni mjetet jashtë gjykatave, siç është kërkesa për falje apo amnisti, apo mjete juridike që nuk janë të lejuara me ligj. Gjithashtu, lutjet (në Kuvend, te Presidenti apo te Qeveria, te një ministër apo te Avokati i Popullit) nuk konsiderohen të jenë mjete juridike efektive që duhet t'i keni shfrytëzuar për të përmbushur kriterin e shterimit të mjetit juridik, si më lart.

Plotësimi i formularit të kërkesës

11. Para se të plotësoni Formularin e kërkesës, duhet të lexoni me kujdes rregullin 27 (Adresa për dorëzimin e dokumenteve) dhe rregullin 28 (Zbatimi i dorëzimit) të Rregullores së punës, si dhe t'i kushtoni vëmendje pikave në vijim.
 - (a) Nëse konsideroni që ankesat tuaja kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë, si dhe që kërkesat e përshkruara si më lart janë përmbushur, plotësojeni me kujdes dhe në mënyrë të qartë Formularin e kërkesës, si dhe dërgojeni në Gjykatën Kushtetuese sa më parë që është e mundur, bashkë me dokumentet relevante, që nevojiten për shqyrtimin e saj.
 - (b) Duhet të zgjidhni dhe të përdorni një nga gjuhët zyrtare në Kosovë, që janë gjuha shqipe dhe serbe, apo njërën nga gjuhët në përdorim zyrtar në Kosovë.
 - (c) Kërkesa juaj duhet të parashtrahet personalisht në Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese, brenda orarit të rregullt të punës, me postë, në mënyrë elektronike përmes postës elektronike të Gjykatës apo me faks, në numrin e publikuar në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, duke bashkëngjitur kopjen e letërnjoftimit tuaj apo një dokumenti të vlefshëm identifikues. Nuk mund të parashtroni kërkesë në Gjykatën Kushtetuese nëpërmjet telefonit. Formulari i kërkesës mund të plotësohet me dorë ose në formë elektronike, përmes kompjuterit.
 - (d) Nuk mund të prisni këshilla ligjore nga Sekretaria e Gjykatës, pasi që nuk i lejohet një gjë e tillë, as sa i përket kërkesës tuaj, e as sa i përket interpretimit tuaj.

Përmbajtja e kërkesës

12. Kur plotësoni Formularin e kërkesës, duhet të siguroheni që ai të përmbajë pikat në vijim:
 - (a) Emrin, mbiemrin dhe adresën tuaj, të shkruar në mënyrë të lexueshme në Rubrikën "A" të Formularit të kërkesës, nëse jeni person fizik, ose në Rubrikën "B" të Formularit të kërkesës, nëse jeni person juridik (si p.sh: kompani, organizatë jo-qeveritare, asociacion). Nëse një kërkesë parashtrahet nga më shumë se një parashtrues, duhet të ofrohen të dhënat për secilin prej tyre;

- (b) Emrin, mbiemrin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse keni, në Rubrikën “C” të Formularit të kërkesës. Për qëllimet e parashtrimit të kërkesës, nuk është e domosdoshme të përfaqësoheni nga avokati, e as nuk ka nevojë që përfaqësuesi juaj të jetë jurist. Nëse jeni të përfaqësuar, Formulari i kërkesës duhet të shoqërohet me një dokument autorizimi, të nënshkruar nga ju dhe avokati, apo përfaqësuesi që vepron në emrin tuaj (shih mostrën e bashkëngjitur me këtë dokument). Përfaqësuesi i subjektit juridik (kompania, shoqata, etj.) ose i grupit të individëve, duhet të ofrojë dëshmi të autorizimit nga personi i autorizuar i subjektit juridik apo i grupit të individëve që përfaqëson;
- (c) Emrin, mbiemrin dhe adresën e palës apo të palëve kundërshtare në Rubrikën “D” të Formularit të kërkesës, si dhe palën apo palët e interesuara (nëse ka dhe nëse dihen), si dhe informatat përkatëse për atë/ato palë në Rubrikën “E” të Formularit të kërkesës. Gjykata Kushtetuese do t’ia dërgojë palës/palëve përgjegjëse kopjen e kërkesës suaj, duke iu mundësuar asaj/atyre të dërgojnë komente për kërkesën tuaj;
- (d) Një përshkrim të përmbledhur të fakteve, duke dhënë hollësi të qarta dhe koncize për aktet ndaj të cilave ankoheni (pjesa II e Formularit të kërkesës). Duhet t’i jepni datat e sakta dhe të përshkruani ngjarjet sipas rendit kronologjik në të cilin kanë ndodhur. Nëse ankesat tuaja kanë të bëjnë me një numër çështjesh të ndryshme, për shembull me disa procedura gjyqësore, duhet ta trajtoni secilën çështje ndaras. Të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me faktet që ndërlidhen me këtë kërkesë duhet të përmbledhen në pjesën II të formularit, në maksimum tri (3) faqe. Nuk është e pranueshme që kjo rubrikë të lihet e zbrazët duke iu referuar sqarimeve të paraqitura në dokumente shtesë. Gjithashtu, nuk është e pranueshme që kjo rubrikë të adresojë vetëm një pjesë të fakteve ndërsa për pjesën tjetër t’i referoheni dokumenteve shtesë. Përderisa sqarime shtesë mund të dorëzohen, Gjykata duhet të jetë në gjendje të kuptojë faktet relevante të kërkesës në tërësi përmes kësaj rubrike, pa pasur nevojë për plotësime shtesë;
- (e) Arsyetimin e kërkesës, duke shpjeguar sa më saktë që mundeni, se cila është ankesa juaj sipas Kushtetutës (pjesa III e Formularit të kërkesës). Duhet të saktësoni nenin e Kushtetutës apo të Konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës sipas Kushtetutës, që pretendoni se iu është shkelur nga autoriteti përkatës apo gjykata, duke iu referuar aktit të autoritetit përkatës apo vendimit të gjykatës që ka shkelur të drejtat dhe liritë tuaja të garantuara kushtetuese. Të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me pretendimet që ndërlidhen me këtë kërkesë duhet të përmbledhen në pjesën III të formularit, në maksimum shtatë (7) faqe. Nuk është e pranueshme që pjesa III e formularit të lihet e zbrazët duke i’u referuar pretendimeve të paraqitura në dokumente shtesë. Gjithashtu, nuk është e pranueshme që në këtë rubrikë t’i referoheni vetëm një pjesë të pretendimeve, ndërsa për pjesën tjetër të pretendimeve t’i referoheni dokumenteve shtesë. Përderisa sqarime shtesë mund të dorëzohen, Gjykata duhet të jetë në gjendje të kuptojë pretendimet tuaja për shkelje kushtetuese lidhur me këtë kërkesë përmes kësaj rubrike, pa pasur nevoje për plotësime shtesë. Gjithashtu, pretendimet e juaja për shkelje kushtetuese, duhet t’iu referohen neneve specifike kushtetuese që pretendohet se janë shkelur, duke shpjeguar në hollësi, si dhe pse ka ardhur deri te shkelja e nenit përkatës të Kushtetutës apo Konventave drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës;
- (f) Dokumentacionin dhe informatat e tjera përcjellëse, që vërtetojnë se keni respektuar rregullin e shterimit të mjeteve juridike (pjesa IV e Formularit të kërkesës). Nëse keni pasur një mjet juridik në dispozicion, sipas ligjeve në fuqi, por

nuk e keni shteruar, duhet të shpjegoni arsyet e mos shterimit të atij mjete juridik përkatës. Tregoni, gjithashtu, nëse keni shfrytëzuar mjete të tjera. Nëse e keni bërë këtë, duhet të ofroni hollësi, duke përfshirë edhe titullin e organit tek i cili keni parashtruar ankesën tuaj, datat dhe detajet e procedurave të iniciuara, si dhe hollësitë e vendimeve të nxjerra në këto procedura;

- (g) Dokumentacionin dhe informatat e tjera përcjellëse, që vërtetojnë se keni respektuar afatin katër (4) mujor për paraqitjen e kërkesave (pjesa V e Formularit të kërkesës). Nëse nuk keni paraqitur kërkesën tuaj brenda afatit katër (4) mujor, dhe nëse kërkonti kthim në gjendje të mëparshme sipas nenit 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ose nëse konsideroni se në rastin e juaj ka “shkelje të vazhdueshme”, luteni të shpjegoni arsyet për këtë në kërkesë;
- (h) Bashkëngjitni një listë të të gjitha dokumenteve, përfshirë aktgjykimet dhe aktvendimet relevante, si dhe dokumentet e tjera që dëshironi që Gjykata Kushtetuese t’i marrë parasysh si dëshmi (transkripte, deklarata dëshmitarësh, parashtrësata tuaja për autoritetet dhe për gjykatat e ndryshme), siç përmenden në pjesën VI të Formularit të kërkesës;
- (i) Kopjet e dokumenteve përkatëse të dorëzuara në mbështetje të kërkesës, duhen të bashkëngjiten me kërkesë, kur ajo dorëzohet në Gjykatën Kushtetuese. Nëse vetëm pjesë të caktuara të dokumentit janë të rëndësishme, vetëm ato pjesë duhet bashkëngjitur. Dokumentet mund të dorëzohen në një prej gjuhëve zyrtare të Kosovës ose në një nga gjuhët në përdorim zyrtar në Kosovë;
- (j) Kur një dokument nuk është në një nga gjuhët zyrtare apo në një nga gjuhët në përdorim zyrtar në Kosovë, dokumenti duhet të shoqërohet me një përkthim të certifikuar në një nga gjuhët zyrtare, ose në një nga gjuhët e tjera në përdorim zyrtar në Kosovë. Mund të përkthehen vetëm pjesët e rëndësishme të një dokumenti, por në një rast të tillë, ato duhet të shoqërohen me një shpjegim se pse janë përkthyer vetëm ato pjesë të dokumentit;
- (k) Asnjë dokument nuk do t’ju kthehet. Pra, është në interesin tuaj të dorëzoni kopje dokumentesh, e jo dokumente origjinale;
- (l) Formulari i kërkesës tuaj duhet të përmbajë datën e dorëzimit dhe nënshkrimin tuaj. Mbani mend që, nëse kërkesa dorëzohet nga përfaqësuesi juaj, Formulari i kërkesës tuaj duhet të shoqërohet me një dokument autorizimi, të nënshkruar nga ju dhe nga përfaqësuesi juaj (shih mostrën e dhënë në këtë dokument).

Publikimi dhe konfidencialiteti

13. Në përgjithësi, informatat brenda dokumenteve që dorëzoni ju në Sekretariat, duke përfshirë informatat për juve, ato për palën e kundërshtuar, apo për personat e interesuar, do të jenë të qasshme për publikun, në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike. Në pajtim me këtë, kur ofroni hollësi për jetën tuaj private apo të palëve të tjera, ofroni vetëm hollësi që janë thelbësore për kuptimin e kërkesës.
14. Përveç kësaj, nëse nuk dëshironi që identiteti juaj të zbulohet publikisht, këtë duhet ta theksoni, si dhe të ofroni arsyet për një shmangie nga rregulli i qasjes publike në informata mbi procedurat. Gjykata Kushtetuese mund të autorizojë moszbulimin e identitetit në raste të jashtëzakonshme dhe të argumentuara. Sigurisht, nëse lejohet

moszbulimi i identitetit, emri juaj duhet t'i zbulohet palës së kundërshtuar, kur kërkesa i komunikohet asaj pale për komente.

Vërejtjet përfundimtare dhe rekomandimet

15. Ju lutemi, mos i mbyllni me shirit ngjitës dhe mos i lidhni në çfarëdo mënyre korrespondencat me Gjykatën, ose dokumentet që i dërgoni në Gjykatë. Të gjitha faqet duhet të kenë numra të njëpasnjëshëm.
16. Kërkesa juaj, si dhe korrespondencat e mëtutjeshme, duhet dorëzuar në këtë adresë apo përmes postës elektronike (e-mail):

*Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
Sekretari i Përgjithshëm*

*Rr. "Perandori Justinian", nr. 44
Republika e Kosovës
10 000 Prishtinë*

*Tel: +383 (0)38 606 162; Fax: +383 (0)38 606 170;
E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org*

17. Pas pranimit të letrës tuaj të parë ose pas pranimit të Formularit të kërkesës, Sekretaria e Gjykatës do t'ju përgjigjet duke ju informuar se kërkesa juaj është regjistruar në regjistrin përkatës të Gjykatës, me një numër të caktuar. Ai numër duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat pasuese me Gjykatën Kushtetuese. Rrjedhimisht, nga ju mund të kërkohen informata apo qartësime shtesë, dokumente apo gjëra të veçanta rreth ankesave tuaja.
18. Është në interesin tuaj që të përgjigjeni sa më shpejt në çdo korrespondencë me Sekretarinë e Gjykatës.
19. Çdo vonesë ose çdo dështim për t'u përgjigjur, apo për të dhënë informata shtesë, mund të kuptohet që ju nuk dëshironi të ndiqni më shqyrtimin e rastit tuaj, si dhe mund të çojë në rastin që kërkesa juaj të mos shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese, dhe të refuzohet me procedurë të shkurtër.
20. Ju do të informoheni për çdo vendim të marrë nga Gjykata.

Dokument autorizimi për përfaqësim
(mostër)

Unë,

.....

(Emri dhe adresa e palës që parashtron kërkesë)

Me këtë dokument, autorizoj

.....

(Emri, adresa dhe profesioni i përfaqësuesit)

të më përfaqësojë në procedurë para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për sa i përket kërkesës sime të parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me nenin 47 (Kërkesat individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së:

.....
 marrë nga

.....
 (Vendi dhe data)

.....
 (Nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës)

Nëpërmjet këtij dokumenti, e pranoj autorizimin si më lart,

.....
 (Vendi dhe data)

.....
 (Nënshkrimi i përfaqësuesit)